



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.686/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fatmir Baliu kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc, të paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, për Zgjedhjet lokale të 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.686/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Fatmir Baliu kandidate për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të verifikim të rezultateve në vendvotimin 0318E/01R, 0318E/02D, për Zgjedhjet Lokale 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar ankesën Anr.686/2021, nga Fatmir Baliu kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc, në të cilën thekson se në qendrat e votimit 0318E/01R, 0318E/02D, dyshohet se ka pasur keqpërdorim të votave nga personat pergjegjës, më tutje thekson se për ta vërtetuar këtë mund të kontaktohen personat të cilët e kanë votuar ku ka bashkangjitur edhe deklaratat me shkrim nga Eliot Istogu dhe Naim Veliu.

Si deshmi ankesës i ka bashkangjitur deklaratat me shkrim nga Eliot Istogu dhe Naim Veliu..

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlersimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet me nr. 0318E/01R, 0318E/02D, në Komunën e Glllogocit, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljës së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljën e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Fatmir Baliu nuk e paragjykon çështjën dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljës të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 686/2021 më datën 20.10.2021

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

